

lexime ballkanike

p r o z a

seria: letërsi bashkëkohore nga Ballkani
konceptuar dhe përzgjedhur nga Arian Leka

Vladimir Arsenijević | Në hambar
Titulli i origjinalit: U Potpalublju

copyright © Vladimir Arsenijević & RENDE, 2006

copyright © i botimit shqip,
i shpërndarjes dhe i promovimit POETIKA dhe IDEART
© copyright of the translation: S. Fischer Foundation by order of TRADUKI

ISBN 978-9928-128-02-7
redaktor: Silvana Leka
realizimi grafik: Genc Goga

Botimi i kësaj vepre u mbështet nga TRADUKI, një rrjet ndërkombëtar, të cilit i përkasin Ministria Federale për Çështje europiane e ndërkombëtare e Republikës së Austrisë, Ministria e Jashtme e Republikës Federale Gjermane, Fondacioni kulturor zviceran Pro Helvetia, KulturKontakt Austria, Instituti Goethe, Fondacioni S. Fischer, Agjencia sllovene e Librit JAK dhe Ministria e Kulturës e Republikës së Kroacisë.

traduki

traduki

Shënim: Për përkthimin është përdorur botimi
RENDE, 2006
ISBN 86-83897-44-3

NË HAMBAR

Përktheu nga origjinali Ben Andoni



botimet poeteka

botimet
ideart 

Për Slexhanën dhe Filipin

Tetor 1991

Për mëdyshjet e krevatit - Anxhela, unë dhe dikush tjetër
(dukja e të cilit pritet)
- Vizita e Llazarit - Skicë mbi Ekzekutuesit
dhe Urdhëruesit - Përse e kam frikë kurajën e Anxhelës -
Tinguj nga përroi

Për mëdyshjet e krevatit

Në një çast të caktuar të jetës sime, i cili nuk më vjen më ndërmend, diku aty mes moshës njëzetë e pesë dhe tridhjetë vjeç, m'u përvijua nevoja për një ritual të veçantë e të përditshëm. Ai ritual lidhej me kategorinë e atyre zakoneve shtëpiake, të cilat në moshën e pubertetit na ndihmojnë t'i urrejmë mirëfilli e në detaje baballarët tanë. Në kohën e moshës së tyre të mesme, këta mbërthehen në zakone të tilla, ku na duket se janë dëshpërimisht të pajtuar me mashtrimin, se jeta është thjesht një listë veprimesh të shumëpërdorura, të cilat kurrë s'mund të vihen në dyshim. Rituali im i parë i pjekurisë kishte të bënte me sa vijon: Çdo pasdite, pas punës dhe drekimit, tërhiqesha në dhomën e gjumit të apartamentit, të cilin e ndaja me Anxhelën në rrugën *Molier*, dhe ku e lëshoja veten në një lloj zhgjëndrre të makhët. Plandosur mbi shpinë të krevatit martesor, duke nderuar të drejtën e pashkruar të Zakonit, shtriqesha pa lëvizur fare vendit, si të isha një trung. Sytë i mbaja mbyllur, madje as qepallat nuk më lëviznin. Por nuk flija. I mbledhur tek vetvetja, thjesht torturohesha me veprimin sikur isha para një audience jo të pranishme me idilin e gjumashit të pasdites, kurse në të vërtetë, thellë në vete isha krejtësisht zgjuar, isha në fakt i shpërbërë në pavendosmëri.

Ndonëse kurrë s'arrita të kuptoja këtë lloj meditacioni negativ transcendental, e praktikova atë gjerësisht e me ngulm dhe e mbaja me vete pa as edhe murmurimën më të vogël. Do kishte qenë, sigurisht, më e ndershme - dhe ndoshta dhe më e shëndetshme - t'ia merrja ndonjë sy gjumë.

Ndërgjegjja e tim eti ishte gjithnjë pa të metë dhe ai mund të gërhiste çdo pasdite tmerrësisht, pa ia vënë veshin urrejtjes që mundohem t'ia largoj nga dhoma ime, duke shpresuar në jermi patetik të pesëmbëdhjetëvjeçarit, që babai im thjesht të shembet në gjumë, nën presionin e urrejtjes që drejtoja tek ai. Dhe tani, pas kaq vjetësh, shtrënguar në brazdën mes Këputjes dhe Fajësisë, nuk isha i aftë madje as të flija, ashtu siç doja. Mbyllja sytë dhe përpiqesha të isha krejt i vetëdijsëm pas asaj perdeje. Në ato çaste (kur nga jashtë dukem krejt i qetë: i braktisur në gjumin e përforcuar) makthi ishte kaq i madh, sa që fytyra ime vuante prej një spazme të brendshme dhe nëse do kisha dëshiruar që eksperimenti ku t'i sajoja buzët e mia për një buzëqeshje të funksionojë, do të më duhej të udhëtoja plot gjysmën e botës, nga njëra faqe tek tjetra.

Nëse i kujtoj përnjëmend mbrëmjet e tetorit të njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e treshit, ato ishin disi të ciflosura dhe gjelbëroshe. Në rrugën *Molier* kisha sak atë ndjesinë, sikur përgjatë ditëve, një re e çuditshme lundronte mbi të. Shtjella e erës nën dritaret e katërkatëshit me tullat e verdha, i shpërndante gjethet e grimcuara. Ndërsa mbrëmjet, ku ajri kundërmonte erën e vjeshtës së ardhshme, ishin kaq të ndyra, sa që as edhe ndonjë amator i gjumit të mbrëmjes nuk do donte të ngrihej. Çdo aktivitet sillte mundësinë e telashit, kështu që ai ndjente frikë nga detyrimi për të larë kokën, për shkak se mbase shampoja do i kërcente dhe do i digjte sytë, zbythej nga mendimi për dhimbjet e kokës që e prisnin, pasi kish përdorur tharësen e flokëve, ai është plot frikë gjithashtu për gjumin e keq, të cilin e di që do ta torturojë dhe nëse do të marrë receptorin të telefonojë një të dashur, ai s'duhet të jetë i befusuar nëse aparati i thjeshtë do ta trallisi apo nëse (duke shpërfillur nevojën e shprehur të tij të mëdyshjes për kontaktin reciprok pa intimitet) zëri miqësor në anën tjetër të linjës, ftohtë do i hidhte poshtë

kërkesën që ai në mënyrë verbale e prostituonte vetaz si një dashamirësi për vetë atë, qoftë edhe pa rënë dakord për një çmim në paradhënie dhe në kthim për shtrydhjen e tij jashtë. Deri në pandjenjë.

Në atë kohë, për aq sa i përkiste artit të "dremitjes" së pasdites, kisha përparuar tej nivelit të amatorit, por atëherë dridhesha, mposhtur prej konfuzionit të veçantë të gjumashit. E dija, natyrisht, se asgjë nga këto gjëra të thëna më sipër do mund të ishte veçanërisht e tmerrshme, por s'kisha forcë ta përballoja jetën e përditshme. Telashi, mendoja, kërkon telashin. Ato mund t'ia hipnin njëra-tjetrës dhe nuk më jepej ta përballoja këtë përrua, kur filloi të uturinte. E shikoja veten qetë para një katastrofe të pashmangshme, njësoj si vici i urtësuar para vendimit të sëpatës së kasapit.

Ndaj, edhe nëse do ndodhte që Anxhela të më thërriste nga dhoma e ndenjes, i përsërisja vetes se do e lija atë të thërriste, s'kishte rëndësi se çfarë donte, s'doja thjesht të përgjigjesha. Zëri i saj do drithëronte në sustat e krevatit, por unë i bëja ballë atij me sytë e mbyllur. Doja që deri në fund të ndieja eksperiencën e të qenit fajtor, por që e shmang përcaktimin e tillë - fajtor për shkak të trupit tim që më bënte kaq të plogët - duhet të ishte gjithsesi më i fortë, madje edhe nga ky zë. Deri më atëherë, në këtë tetor, ashtu si gjithnjë më parë ose më pas, s'mund të bija në një mendje me të dhënat e mbledhura në librezën time shëndetësore për këtë trup, bashkë me gjithë kufizimet dhe jo përkryerjen e tij, që më duhej ta pranoja si timin, e kur ndërkohë tek ai lundroja njësoj brenda si të isha një embrion në lëngun amniotik ¹.

Në ndryshim me kacakun e trupit, të cilin kurrë s'kisha qenë i aftë për ta kuptuar, në bluzën me të cilën isha i shtrirë në atë tetor, kundërmonte esenca brilante e vetë asaj. Me aq sa kujtoja, ajo kurrë s'më kishte dhënë asnjë befasi, çdo

¹ Lëngu amniotik është lëngu ushqyes dhe mbrojtës që përmbahet nga qeska amniotike e gruas shtatzënë. (Shënime të përkthyesit)

ditë mbante cilësitë që kishte pasur një ditë më parë, krijuar si enkas për të më kujtuar se e bleva të më përshfaqte në publik, por s'ka çmim që mund ta zëvendësojë një shërbim të tillë. Dhe kur një ditë e hodha si të përdorur - e dija (ja sepse kryesisht e mbaj derisa fle/nuk fle) - ishte njësoj sikur ta hidhja tutje një version të pazëvendësueshëm të vetes: një pikë e madhe në fund të një kapitulli jo të rregullt.

Anxhela, unë dhe dikush tjetër (dukja e të cilit pritet)

Anxhela, me barkun e saj deri te goja, nuk erdhi të "më zgjojë" deri aty pak para mbrëmjes. Me barrën e saj të përparuar ankohej shpesh prej gazrave dhe cistitit. Ishte gati të urinonte tri herë në orë. I ulur në buzë të vaskës sime po prisja radhën, derisa ajo, me këmbë të hapura siç qe, shtypi deri në fund mekanizmin e WC-së. Pa e ndryshuar pozicionin, ajo i hodhi ujë të bollshëm kofshëve të saj me një lëvizje profesioniste të dorës. Kur pas kësaj, pavarësisht barkut të fryrë, u ngrit me një hovje, afroi mbathjet të cilat i kishin rrëshqitur deri në gju dhe tha, sikur tamam e gjitha kjo të kishte ndonjë lidhje: "Roma!"

E gjithë fytyra e Anxhelinës në atë çast flakëroi me një qortim të përqendruar keq. Ndoshta duhej të habitesha, por dikur kisha pasur gati një përvojë të ngjashme. Një vit më parë, në mesin e Romës, ndërsa numëronim javën e dytë të muajit të mjaltit, ngarkuar me kartolina dhe pullat e postës, të cilat ajo i shkatërroi ngaqë i derdhi sipër filxhanin plot me çokollatën e nxehtë, po me të njëjtën shprehje qortimi më kish thënë: "Londër!"

Pas kësaj, e kujtoj shumë mirë, qarkulluam pa fund në qytet, kapur dorë më dorë. Jam i sigurt se nëse Anxhela do donte t'i shikonte kishte shumë gjëra që mund të zbulonte për veten në Romë: manastiret rrethuar me kopshtet parajsorë, ku lulëzonin palma dhe portokallë, hallakatur mbi kodrën e vogël, nga e cila mund të shikojë të gjithë qendrën antike të qytetit, mbetjet e ndryshme që përshfaqnin shekujt e

shkuar, shkallaret e nxira, ku këmba e dikujt tingëllonte si me brengë, më afër pastaj me udhët e trishtuara, në komplekset e vilave të mëdha me kopshtet plot me selvi dhe pisha, të nxehtë të skëterrë të shtatorit, tunelet e 1600 kishave, kupolat e Renesancës, që shndritnin në diellin e paradites, tarracat e mbuluara me bar dhe liana të banesave luksoze me papafingo, në të cilat shullëheshin për banjë dielli burra ezmerë, sokakë në të cilat shiteshin vetëm pajisje për ceremoni fetare: mitra dhe gjithë veshjet apostafat të priftërinjve, engjëj të gurtë me shpata të tërhequra, konkubina moderne me motorë, obeliskë në majë të elefantëve dhe më pas – Katakombe, kishëzat e dekoruara me eshtrat e copëtuara të kapuçonëve.

Por Anxhela, deri në fundin e muajit të mjaltit, mbeti shpërfillëse dhe madje e bezdisur nga huret e Romës. E vetmja që vërtet i dukej e bekuar atje, më duket se ishte një librari, një vend i vogël pak me pluhur me aromë të pashëndetshme, ku zbuloi të pacenuar *London Streetfinder* me një shtojcë plot fotografi të retushuara të pamjeve dhe për të cilin ajo kujdesej me orë tëra, duke e përkëdhelur me një pamje adhuruese.

Duke shqiptuar "Romë" - me mospërfillje dhe me një domethënie të veçantë - lëshoi ujin. Ndërsa lagte dy copa letrash, rryma e pastroi humorin e keq të pasgjumit tim. Rreth këmbës po më varej Faraoni, maçoku i Anxhelës. I dhashë atij një shkelm të fshehtë (Anxhela do të tërbohej) dhe e ndoqa gruan njëlloj si një kafshe besnike, ashtu si Faraoni më ndiqte kur ishte i uritur, përgjatë udhës së ndërlikuar, përmes hollit, dhomës së ngrënies dhe drejt e në kuzhinë. Nuk kisha shkuar akoma atje dhe ajo ende s'kishte vendosur ujin për çaj, kur Anxhela zgjodhi të zhvillonte temën e hapur, që e çeli në banjë.

"Sot kam menduar diçka", tha duke mbledhur flokët. "Në fakt kemi pasur një kohë super në Romë, ë? Tek e fundit s'kemi pse të ikim në Nju Jork. Ne të dy dhe bebja, mendoj -vërtet do ishte bukur të jetonim në Romë. Dhe është afër, kupton!" Beogradi, fare thjesht, e rraskapiste.

Atë paradite, ndërsa udhëtonte me tramvajin numër 7 nga Blloku 45, kohë kur kish vendosur të vizitonte prindërit dhe doktorin e saj, ishte e detyruar të shmangte vështrimin nga bashkudhëtarët e tmerrshëm përreth. Natyrisht, ajo s'donte të shikonte jashtë dritares dhe të përballej me panoramën teheraniane të Beogradit të Ri, ndaj ktheu vëmendjen tek libri që ia kisha rekomanduar si SHTQ². Ndoshta i duhej diçka më shumë torturoese për kokën, por ajo kishte kërkuar "diçka të gëzueshme", ndaj i zgjodha *Gargantuanë* e Rabëlesë, thellësisht i sigurt se asgjë nuk mund të jetë e gëzuar nga kjo jetë e frikshme. Megjithatë, doli që Anxhelës ky tekst iu duk si i vështirë për t'u kuptuar dhe, pos të gjithave, edhe i mërzitshëm.

Dhe kështu ndodhi, që unë me një lugë çaji në dorë u bëra fajtori kryesor për gjithçka që kish ofenduar soditjen e saj këtë mëngjes - nga të saçmat e hundës së udhëtarit, për arkitekturën e keqe, për hapësirën e jashtme të shkrumbuar dhe deri për humorin e Renesancës. Ndërkohë s'iu përgjigja akuzave. U përmbajta. Isha në gjendje ta kuptoja nervozizmin e Anxhelinës. Në çdo rast do të gjeja disa mënyra të arrija në termin për ndjesinë e fajtorit që sapo më zbrazti. Dhe, sa për të, ajo aq shumë sa shurronte, po aq shumë edhe qante. Ishte me sa duket i gjithë ai ujë i derdhur në shalët e saj apo ndonjë gjë tjetër që në të vërtetë kish kuptuar se muaji i shtatë po kapërcehej me vështirësi, por të gjitha këto gjëra të pakënaqshme do të zhdukeshin sapo Anxhela do arrinte në qëllimin e përfundimit të këtij udhëtimi rraskapitës me barrën e mrekullueshme në krahët e saj.

Shtiva çajin në filxhan, qumësht në enën fine qeramike, të cilën na e kishte dhuruar nëna ime me rastin e shpërnguljes së Anxhelës në rrugën *Molier*, nxora sheqerin dhe shtova prekjen finale: një qeshje pajtimi. "I pështirë Beogradi", i pohova. "Po mund të jetë dhe Rabële i mërzitshëm".

² Shërbimi i Transportit Qytetar.

Por edhe pse nuk e mendoja kështu - e thashë këtë jashtë vlerësimit për ndjeshmërinë e re të Anxhelës, i vendosur për ta lënë sherrin, duke e marrë të gjithë fajin mbi vete. Gjithsesi, kush e çante kokën për Rabëlenë? Isha i vendosur se duhej të rrija me orë të tëra të lëpija plagët nën kapelën e Fajtorit në qoshen e dënimit të martesës sonë, vetëm që Anxhela të mos shqetësohej pa ndonjë arsye. U ngushëllova me mendimet se do ta shikoja atë të merrte ndëshkimin e saj, ashtu si duhej, kur të lindte dhe të rritej biri ynë. Iu betova vetes se do ta rrihja atë pamëshirë, kur të dy të ishim të vjetër dhe të zbardhur, për ato plagët që më kish dhënë për dekada, që përndryshe ia atribuojë vetes si një kafshë - ndaj në këtë logjikë ishim të ngjashëm. Faraoni dhe unë - kishim marrë shuplaka në vetmi, të pahallakatur për ankime shterpë.

Më duhej pasardhësi si një analgetic-placebo³. Për këtë qëllim, duke shfrytëzuar përparësinë e epërme të mashkullit, e kisha mbarsur Anxhelën, megjithëse kishte mundësi që edhe ajo, ta shikonte po ashtu këtë gjë, si një përfitim shumë personal i së njëjtës gjë. Gjithsesi, barku i saj ishte rritur habitshmërisht shpejt, sa që kërthiza i kishte kërcyer jashtë si tapë dhe nga atëherë mbeteshin dhe nja dy muaj deri në ditën kur një qenie e llojit të tij - Biri ynë - do të dilte prej saj! Kuptohet se isha krenar për këtë, por ashtu si barku i saj po rritej, po ashtu edhe më shumë isha i frikësuar prej këtij fëmije misterioz. E përfytyroja atë të pandihmë, por besnik, luajal dhe njëkohësisht edhe shpërfillës dhe përfundimisht haptazi rebel, i vendosur të më shkelte! Dhe ndoshta kur të vinte koha për rebelimin që t'i shpërthente, unë vetë do të isha duke gërhitur zëshëm për çdo mbrëmje, pa as edhe shqetësimin më të vogël dhe do më urrente, ashtu si unë urreja babanë tim, përmes murit të hollë që ish futur në mes të dhomave tona të gjumit. A do mundja ta kuptoja kur

³ Analgesiku është një përbërës i grupit të drogave përdorur për të qetësuar dhimbjet, ndërsa placebo është një medikament artificial për intervenime.

ai s'do donte të më merrte vesh apo do të mbuloja veten turpshëm me leckat e një lidhje të shprishur? - kjo ishte një pyetje qendrore e të qenit baba.

Anxhela ishte e qetë. Po e zbaviste veten duke bërë një cigare marihuanë. Pranë saj po ngrohja veten me çaj, i mbytur në dilema të pazgjidhshme. Ç'do të ndodhte nëse ky fëmijë do të lindte mendjemadh?, -përsiatja gati në këqyrjen time e që më parë i paduruar për betejën ende të pafilluar dhe kaq të komplikuar. A do mundej mbrojtja ime e ngathët e babait-rishtar të arrinte të bëhej një mbrojtje efektive me një fëmijë të tillë? Apo do të merrnim frymë njëri nga tjetri nga goja, im bir dhe unë, si dy boksierë të rraskapitur, derisa të dy të shkatërroheshim, të dobësuar në zgrip nga goditjet poshtë brezit?

Vizita e Llazarit

Sipas disa rregullave që i kish vendosur vetë, çdo të shtunë paradite na vinte për vizitë Llazari, vëllai i vogël i Anxhelës. Me vete sillte një koktej jo të zakonshëm me çaj bimësh - një përzierje e vet - mbartur brenda një qeseje transparente, lidhur me një fije gomë të kuqe dhe me këtë përgatiste pastaj një pije të butë, pa sheqer. Ndërsa qëndronte ulur (sajonte një si stol që ne e përdornim kur na duhej të ndërronim siguresat apo të arrinim ndonjë nga librat në majë të raftit), ngrinte ngathët rrobën e tij ngjyrë shafrani që i shërbente në vend veshjes dhe ajo i hapej rreth gjunjëve të tij eshtakë, duke zbuluar këmbët qose të holla djaloshare. Humbur nën xhupin shumë të madh bërë me vetë duart e tij, të ashpër si qimet e qenit, do hiqte kapelën nga i njëjti material i ngjashëm me një lëvizje të shkurtër. Çdo herë mrekullohesha me këtë çast të jashtëzakonshëm, kur kafka e tij ndriçonte para nesh. Me përjashtimin e një bishti të hollë në qafë, në kokën e Llazarit s'kishte asnjë qime floku. Shpesh pa asnjë paralajmërim, do të na lexonte diçka nga ndonjë prej atyre librave, të cilat gjezdiste nga dera në derë, e ku me vështirësi i shitej ndonjë. Me buzëqeshjen që shprehte një gëzim të vërtetë, ndaj vërtet ishte kënaqësi të dëgjoje atë, të paktën në pak minutat e fillimit, zakonisht do na fliste për tre gunas⁴: Virtytin, Pasionin

⁴ Guṇa (vjen nga sanskritishtja: गुण) që do të thotë një fije, ose pe e një lidhje ose përshtjellje. Në kuptime më abstrakte mund të nënkuptojë një nëndarje, specie, lloje, cilësi, apo një parim veprimi apo tendencë. Në filozofinë Samkhya, këtu ka tre gunas të mëdha, që shërbejnë si ligje veprimi themelore apo 'tendenca' të praktikës (natyrës universale).

dhe Injorancën. Për mua ishte tërheqëse që Llazari asnjëherë nuk u orvat të ndryshonte temën e tij mbresëlënëse dhe që nuk tha kurrë vetë: "Po, herën tjetër do të flas për futbollin!" Ky zbulim e thithte atë dhe mrekullimi që e kapte fliste më shumë në vend të tij. Ai e shihte veten si të pajisur me jetën e pasosur shpirtërore. Ngandonjëherë na fekste mundësi të reja në botën materiale.

"Thuaj faleminderit", paralajmëroja Anxhelën, që e dëgjonte atë pa i luajtur qerpiku.

"Hëm, më mirë s'kemi pritur", do thoshte Anxhela, duke u përmendur. Ajo nuk mund të thoshte "faleminderit" qoftë edhe për shaka.

Gjithsesi, ne kurrë s'ramë në këto shpërthime të filozofisë personale të Llazarit*. Ky udhëtim prekës, ky buding me copa me vizione të adoptuara, pak nga *Bhagavadgita*, kjo zgjidhje e mësimëve të *Sri Srimad A.C. Bhaktivedanta Swami Prabhupade* (të cilën Llazari gjithnjë e më shpesh ia adresonte zotit *Shрила*, apo vetëm *Shрила*, marrë me vete nga lulëzimi spontan i intimitetit të një ane), terminologjia e patrazuar e zhurmës së këmbëve të *Zambakut të Ujit, Ndërgjegjes Krishna, Shkencës Transcendentale*, e gjithë paraqitja e stuhishme e fishekjarrëve së Diturive të tij dhe Injorancës tonë, përmes buzëqeshjes së tij gjithnjë të këndshme, por tani tmerrësisht ngacmuese, - ishte ajo që dikush mund ta gjente në një moment nga ai i huaji me mushamanë spanjolle, por as edhe një gramë të tepërt.

Këtë herë, megjithatë, Llazari ishte dukshëm më i paqetë sesa zakonisht. Si fillim ai i përplasi Reebok-ët në parket**, pastaj pranoi cigaren e marihuanës që iu ofrua dhe që e

*...sepse dhe ju vetë e dini që veladoni nuk të bën prift, na thotë Rabële. Dhe sërish: ...sa të shbuntë janë ata që kanë zakone murgjish, por që nuk janë priftërinj, apo të tjerë mbështjellë me mushamatë spanjolle ndërsa nuk janë spanjollë dhe as kanë dhe me të voglën kurajë spanjolle!... (Shënime të autorit)

**E përse Llazari ishte kaq kontradiktor në lidhje me atletet Reebok, e pse nuk i zëvendësonte ato me ndonjë palë nallane druri, apo sandale bërë nga litari i papërpunuar, kjo ende më mbetej e panjobur dhe për muaj me radhë se ndihja dot veten pa u torturuar me këtë problem pa zgjidhje: çfarë cilësie spirituale dhe çfarë e mbante Llazarin që t'i kishte ato si pjesë përbërëse të kostumit të tij vetjak?

refuzonte gjithnjë, përveçse kur ishte në gjendje të rëndë depresioni apo stresi. Me sa duket, i vendosur të humbte ndërgjegjen, këtë herë e thithi tri herë fort dhe papritmas i feksi drita. Pastaj një kollë e fortë tregoi mungesën e tij të rutinës për këtë gjest dhe veshët e këtij Mësuesi të Madh u bënë të kuq si ato të nxënësit të shkollës. Sapo e mblodhi pak veten nga kolla, sytë iu mbushën me lot dhe u zhyt në çajin e vet. Nga ky lëng pështjellues ai kishte një teknikë magjike, për të thëthitur shpëtimin dhe paqen e shpejtë.

"Nëse do gjesh gjysmë kile mëlçiqka pule do të bëj një sillë të jashtëzakonshme", tha duke m'u kthyer me një zë të thyer shpesh me kollë, por vetëm një sekondë më vonë (pikërisht kur po mendoja t'i përgjigjesha me një koment të ngjashëm autik, shkaku apo asosacionin e të cilit e dija vetëm unë), ai ktheu vështrimin e tij të qetë tek Anxhela. Duke u kthyer nga ata, në atë çast kapa shprehjen e errët dhe me ankth të fytyrës së saj dhe një zarf të kaltër të hapur në duart e saj. Ishte dhe e njoha menjëherë, ajo, thirrja për mobilizim.

Duke ia kthyer zarfin pas në duart e Llazarit, me zërin e dridhur e pyeti: "Kush e mori?"

"Jo, jo - haj' Anxhela, të lutem! Po fillove s' do e kuptosh", ia ktheu Llazari nervoz. "Më dëgjo Anxhela: e di se mamaja e pranoi, *mendoj* që ajo, por vetëm për arsye sepse Mihaillo s' ishte dhe ajo kishte frikë të refuzonte. Ndryshe ti e di, ajo s' do e kish marrë".

"Mos u bëj kar!" i bërtiti Anxhela kaq papritmas sa që Llazari gati ra nga stoli, por ajo ishte e kënaqur me këtë shpërthim të papritur, duke ngrënë thonjtë me zemërim në atë lloj qetësie.

"Pavarësisht", guxoi të shtonte Llazari kur kujtoi se tërbimi kaloi. "E gjitha kjo s' ka dhe aq lidhje. Puna është tek karma".

Ndërsa Anxhela u soll sikur e dëgjo komentimin e tij nuk vendosa të ndërhyj. "Dhe... nuk na ke thënë: Çfarë ke ndërmend të bësh tani?", e pyeta Llazarin, duke lëpirë me pështymë një të sapodredhur, në mënyrë që ai ta digte më qetë. Por tani fjalët e mia e zgjuan Anxhelën gati të përgjumur,

dhe, para se Llazari të arrinte të kthehej e të më jepte ndonjë përgjigje, u hodh nga unë dhe më fishkëlleu në fytyrë.

“Më fal, çfarë do të thuash me këtë: *çfarë ke ndërmend?* Nuk ka se çfarë të ketë ndërmend. Duhet të fshihet”, fishkëlleu dhe me taka siç qe, u kthye nga ana e Llazarit. “Llazar, a kupton se çfarë të thashë?” e pyeti atë me një zë mjaft të qetë dhe të thellë. “*Dubet të fshihesh!*”

Por, Llazari ishte i aftë të tregonte forcën dhe vendosmërinë atëherë kur askush nuk e shpresonte tek ai. Kështu ishte dhe tani. I palëvizur nga stoli i tij, pastroi sërish edhe më tej çajin duke u përpjekur që të dukej sikur nuk merrte pjesë në situatën që e kish krijuar vetë. Duke u kollitur sërish dhe më tej, refuzoi marihuanën nga duart e mia, hoqi dhe gllënjkën e fundit të asaj që kishte dhe qeshi. “Po, unë në të vërtetë nuk e di...”, m’u kthye përgjithësisht me një pyetje. “Mendoj se mund të ketë diçka atje. Ndoshta dhe përgjigjem”.

Dola me të në ditën e nxirë. Të heshtur u zhytëm në tollovi. Një procesion martese me një limuzinë të bardhë na kaloi përballë. Diku larg, kope qensh po ndesheshin shtazërisht. Djersa e sjetullave të Llazarit u derdh përmes veshjes së tij portokalli, sepse ishte ende jashtëzakonisht nxehtë për muajin e tetorit. U endëm në drejtim të tregut. Mes zarzavateve, patateve, frutave, djathit, kajmakut, luleve, peshkut, shpendëve dhe kush e di çfarë rrangullave në pleshtat e pjesëve të pjacës, komunikoni qetazi, por duke iu shmangur vështrimit. Mendoj se kështu e kuptonim më mirë njëri-tjetrin dhe diçka tjetër po na lidhte në këtë moment: çfarëdo që përpiquej, Llazari i frikësohej luftës, por s’do ishte më njësoj për mua. Po megjithatë kështu ishte. Po kush nuk do mund të mendonte se s’isha i tmerruar? Qartësisht po këqyrja rrethin që më ngushtonte. Gjithnjë shumë e më shumë njerëz ishin të zhytur në këtë vorbull. Një ditë, mendova, thërritësit do trokasnin dhe në derën time dhe gjunjët e mi, ashtu si shumë gjunjë njerëzish në muajt e fundit, do të fillojnë të dridhen.

Ja pse dukesha qesharak në këtë orë të pamundësisë time dhe s'kisha turp që vetëm pak më parë e tallja Llazarin. Duke menduar një peshore, këtu mes patateve, llogarita perspektivën time të pjesëmarrjes në luftë, ashtu si edhe atë tjetrën - perspektivën e errët të burgut ushtarak për shkak të mos përgjigjes apo dezertimit, e cila mund të shmangej vetëm nga një ikje/dezertimi të shpejtë dhe nervoz jashtë vendit. Në të njëjtin moment, nga ky, mora vendimin që kurrë asnjëherë nuk do të isha më ironik para të shkretit, vëllait të vogël të sime shoqeje, që për shkak të frizurës allasoj dhe veshjeve, e vërenin me aq dyshim fshatarët përreth. I përfshirë nga kjo masë vale pozitive, u përpoqa të kap vështrimin e tij, që t'i buzëqeshja sinqerisht, dashamirësisht e t'i shfaqja miqësinë. Disi edhe e kapa pamjen e tij, por s'arrita të marr asgjë më shumë nga kjo sesa një buzëqeshje. Llazari vetëm sa shikonte vëngër me sytë e mprehtë si të maçokut. S'ishte, siç kuptova, mundësia e nevojës së papritur për këtë ortakëri në nevojë. Në të vërtetë ma ktheu mirësjelljen me kënaqësi. Asnjëherë s'kishte pasur karakter shenjt.

Më zgjoi mëria e tij tokësore. E zvarrita drejt një bari me sandviç që ndodhej në një dalje nga pjaca. "Hajde marrim ndonjë sandviç", i ofrova me një zë të pafajshëm. Mendoj që Llazari vetëm atëherë e kuptoi qëllimin tim, sepse u gëlltit nervoz te gunga e qafës.

"Unë s'mundem, faleminderit", tha ai, "por, ti... vazhdo...".

Nga një koleksion i tërë gjërash të mëdha, që përfshinte dhe katër variante vegjetariane, zgjodha sandviç me sallatë me mish lope. Dhe Llazarit i ofrova një kaç. "I mirë ky mishi i lopës", i thashë me gojën plotë. Neveria e Llazarit ishte ushqimi im shpirtëror atë tetor, sido që me insistim më kujtonte ato që besonte se meritoja.